



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 177**

**6 nëntor**

**2013**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Urdhër i MPB nr. 635, datë 5.11.2013	Për delegim kompetencash ..... 7621
Urdhër i MPB nr. 636, datë 5.11.2013	Për delegim kompetence ..... 7622

**URDHËR**  
**Nr. 635, datë 5.11.2013**

**PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 15.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Ministrinë e Punëve të Brendshme, Sekretarit të Përgjithshëm, z. Genci Gjonçaj.
  2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga data 11 tetor deri në datën 31 dhjetor 2013.
  3. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij urdhri.
  4. Urdhri nr. 382, datë 31.12.2012 “Për delegim kompetencash”, shfuqizohet.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME**  
**Saimir Tahiri**

**URDHËR**  
**Nr. 636, datë 5.11.2013**

**PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar), si dhe të pikës 12 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 21.5.2003 “Për pozicionin, detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministri”,

**URDHËROJ:**

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme në proceset gjyqësore, të lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë Ministrinë.
  2. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Punëve të Brendshme në proceset gjyqësore, sipas pikës 1 të këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të caktuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar), në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit.
  3. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1 të këtij urdhri.
  4. Për autorizimet e lëshuara nga Sekretari i Përgjithshëm deri në miratimin e këtij urdhri të ri, të cilat janë përdorur ose përdoren për përfaqësim në proceset gjyqësore, efektet e urdhrit nr. 254, datë 26.7.2012 “Për delegim kompetence”, do të shtrihen edhe pas miratimit të këtij urdhri, deri në përfundimin e procesit gjyqësor.
  5. Për autorizimet e lëshuara sipas pikës 1 të këtij urdhri, do të gjejë zbatim ky i fundit.
  6. Çdo urdhër që bie ndesh me këtë urdhër, shfuqizohet.
  7. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria Juridike për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME**  
**Saimir Tahiri**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2013

**AUTORIZIM**

PËR PËRFAQËSIMIN NË ÇËSHTJEN CIVILE ME PALË:

Paditës: .....

E paditur: .....

Objekti: .....

Në mbështetje të neneve 64-77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, dhe të urdhrit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr. .... , datë .....  
"Për delegim kompetence",

**VENDOSA:**

Autorizimin e Z/Znj. ...., me detyrë ....., për të hartuar, nënshkruar dhe dorëzuar ankimin/rekursin, si dhe për të përfaqësuar Ministrinë e Punëve të Brendshme, në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes civile me objektin e sipërcituar, deri në shpalljen e vendimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor/në Gjykatën e Apelit/në Gjykatën e Lartë.

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**GENCI GJONÇAJ**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 4 lekë